



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	39/14
Nr. i fq. / Br. st	-10-
Data: / Datum	27. 02. 2014
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-rë e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,
mbajtur më 30.01.2014

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën 10:10. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Ismet Gashi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mirjeta Salihu, Mentor Ferizi, Muhamrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani, dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - ftoi anëtarët e rindë të kuvendit, që të japid betimin, pasi pesë anëtarët e zëvendësuar të kuvendit dhanë betimin. Kryesuesi i kuvendit në vazhdën e arsyetimit të rendit të ditës propozoi tri pika shtesë të rendit të ditës, në pikën në të ndryshme.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - kërkoi nga kryesuesi i kuvendit që të respektohen dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me dërgimin e materialeve për anëtarët e kuvendit dhe atë shtatë ditë pune para mbajtjes së seancës. Në të njëjtën kohë në emër të grupit parlamentar kërkoi që konform nenit 16, pika 4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, materialet për seancën e kuvendit të dërgohen në kopje fizike, për shkak të kushteve që ekzistojnë aktualisht në sallën e kuvendit. Tutje ai duke iu referuar shpalljes së një konkursi nga ana e kryetarit të komunës për pranimin e dhjetë nëpunësve civilë, në administratën komunale, ceku se është shumë mirë që administrata ka kapacitete financiare për punësimin e dhjetë të rindve, mirëpo konkursi i cili është shpallur e që ai beson që komuna jonë e ka një plan vjetor të rekrutimit të mbështetur edhe me buxhet, e në të cilin jeni bazuar kur keni shpallur këtë konkurs. Në këtë kontekst ai ceku se problemi lidhur me këtë konkurs është fakti se kemi përshtatje të kushteve për kandidatë dhe individë të caktuar, sa që vijmë deri te konstatimi se "vetëm fotografitë nuk kanë dal në këtë konkurs, se cilët kandidatë do të pranohen". Në vazhdim ai vlerësoi se nuk është në rregull që ne vazhdimisht jemi të kritikuar, nga jashtë, në çdo takim që e mbajmë, që ne duhet të ndërtojmë një administratë

profesionale, një administratë siç kërkon shteti jonë i ri, që të ecim përpara, e që antiteza e krejt kësaj është se në këtë konkurs kemi katër apo pesë vende të punës në shërbimin civil, janë shpallur me kushte që kualifikimi të jetë me shkollë të mesme, dhe ku në shumicën e rasteve nuk përcaktohet as çfarë drejtimi kërkohet. Në këtë relacion ai kërkoi nga kryetari i komunës që si zyrtari më i lartë i administratës lokale, e mbi të cilin rëndon barra e përgjegjësisë, që të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe masat e duhura që ta anulojë këtë konkurs dhe të shpallet konkursi adekuat në bazë të kualifikimeve që kërkohen për ato vende të punës e jo në këtë formë. Në fund ai tha se ky konkurs është publik i cili është shpallur në gazetë, por edhe në web-faqen e komunës, të cilin mund ta shohin të gjithë, dhe vlerësoi se ky është një fillim i keq për komunën tonë, nëse vazhdojmë në këtë formë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime, duke shtuar se materialet përikat e rendit të ditës janë dërguar në mënyrë elektronike, por sipas nevojës edhe në kopje fizike dhe theksoi se në praktikën e punës së kuvendit është gati e pamundshe që të respektohet afati (në kohëzgjatje prej shtatë ditë pune) për dërgimin e materialeve dhe ceku se kjo çështje nuk është e rregulluar si duhet. Tutje lidhur me konkursin ai shtoi se nuk ka menduar se do të jetë edhe për një mandat kryetar i komunës, por pavarësisht kësaj gjatë mandatit të kaluar, por edhe aktualisht është munduar të ndjekë një politikë të drejtë. Në këtë kontekst ai u shpreh se gjatë viteve të fundit të mandatit ka menduar se do të ballafaqohet me probleme, dhe pikërisht për këtë arsyen nuk ka shpallur konkurse për vendet e punës në vendet ku shërbyesit civilë të administratës komunale janë pensionuar. Lidhur me këtë ai ka menduar që pavarësisht se cili kandidat do të vjen në postin e kryetarit të komunës, të ketë të drejtën për rekrutimin e stafit të tij, dhe për këtë është vendosur që pikërisht tanë ta shpallim këtë konkurs. Në vazhdim ceku se kryetari i komunës së bashku me qeverinë komunale e ka analizuar këtë konkurs dhe vendet e lira të punës dhe shumica e këtyre vendeve të shpallura, kualifikim i kërkuar është fakulteti. Në fund ai tha se është e drejtë e opozitës që të japë vërejtje, por ne si qeveri kemi menduar se kështu është më së miri.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - në paraqitjen e tij në replikë, ndaj kryetarit të komunës, ceku se nuk ka dal në foltore për ta mashtruar opinionin e as anëtarët e kuvendit, porse e vërteta është se konkursi është i afishuar në web-faqen e komunës, dhe nga aty shihet qartë se katër apo pesë pozita në konkurse janë me kualifikim të mesëm, dhe apeloi tek kryetari se kjo është në kundërshtim me parimet e ndërtimit të një administrative profesionale.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të AAK-së propozoi që si çështje paraprake por edhe si çështje mjafit serioze, duke u bazuar edhe në ngjarjet e fundit që po ndodhin në komunat përreth, që për seancën vijuese të përgatitet një informatë për gjendjen e sigurisë në shkollat tona, sepse kemi raste të rënda tragjike që po ndodhin qoftë në Komunën e Prishtinës apo të Mitrovicës, dhe për këtë kemi nevojë të bëjmë një vlerësim real të subjekteve dhe akterëve, të cilët merren me sigurinë në këto institucione. Tutje duke iu referuar vonesave dhe afateve për dërgimin e materialeve, ceku se duhet të respektohen rregulloret pozitive të kuvendit lidhur me këtë çështje, në këtë kontekst për shkak të rr Ethanave dhe kushteve objektive (mungesës së rrymës, dhe shërbimeve tjera të nevojshme), kërkoi që materialet e kuvendit të dërgohen në kopje fizike. Në vazhdim duke bërë një vërejtje parimore siç tha ai, vlerësoi se propozim-vendimi përfundon e mjetave të lira financiare i dërguar në pikën në të ndryshme, dhe i njëjti pa kaluar në KPF, forum i cili ende nuk është themeluar, konsideroi se kjo qasje e shpejtë dhe ad-hoc, dhe pa një analizë të duhur, andaj për këtë çështje tha se ne duhet që këtë ta analizojmë pakëz më ndryshe dhe se mos të fusim materiale të rendit të ditës aty përfundim. Në fund ai kërkoi nga kryetari i komunës që të paraqesë një informatë me shkrim lidhur me dinamikën e zhvillimit të projektit përfundim të fabrikës së ujit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - kërkoi nga subjektet politike të përfaqësuar në kuvend, që t'i prezantojnë shefat e grupeve parlamentare, kurse në të

njëjtën kohë vlerësoi se pas kërkesave për dërgimin e materialeve në kopje fizike, ai ceku se vitin e kaluar kuvendi ka marrë një vendim për pajisjen e anëtarëve të kuvendit me lap-top, kjo, theksoi ai është bërë me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve, por nese veç vendoset që materialet të dërgohen në këtë formë, atëherë këta lap-top t'i kthehen administratës komunale, e cila ka nevojë për pajisje të tilla.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se gjendja e sigurisë në shkollat tonë, por edhe në komunë në përgjithësi është e mirë, mirëpo pavarësisht kësaj ne në bashkëpunim me DKA-në, por edhe policinë do ta sjellim një informatë për gjendjen e sigurisë në seancën vijuese. Tëtje lidhur me propozim-vendimin për bartjen e mjeteve financiare, ceku se ndoshta vërejtja është me vend sepse DBF-ja është dashur të bënte një specifikim më të hollësishëm të bartjes së këtyre mjeteve. Gjithashtu ai në fund njoftoi anëtarët e kuvendit se projekt i ndërtimit të fabrikës së ujit nuk është përfunduar brenda dinamikës së paraparë, por siç dihet ky është projekt i Qeverisë Qendrore, ku ne nuk kemi mundur të përspejtojmë dinamikën e përfundimit të këtyre punimeve. Për këtë çështje ai u zotua se kuvendi do të informohet në seancat vijuese.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me vota unanimë miratoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja inauguruese e KK-së, mbajtur më 26.12.2013.
2. Shqyrtimi i Draft-Planit Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2014.
3. Shqyrtimi i propozimit për miratimin e vendimit për fillimin e procedurës, për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete.
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
7. Të ndryshme:
 - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara (të lira) nga të hyrat vetanake, nga viti 2013 në vitin 2014.
 - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. drejtorëve në institucionet edukativ-arsimore dhe aftësuese.
 - c). Shqyrtimi i kërkesës i Kishës Ortodokse në Vushtrri, për ofrimin e ndihmës financiare.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja inauguruese e KK-së, mbajtur më 26.12.2013.

Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Draft-Planit Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2014.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - njoftoi anëtarët e kuvendit se Plani i Punës i Kuvendit, është praktik që të hartohet në fund të vitit, me qëllim që viti të fillojë dhe aktiviteti i kuvendit të bazohet në plan, në rastin konkret, për shkak të zgjedhjeve të mbajtura vitin e kaluar, si kuvend kemi qenë të penguar për të hartuar këtë plan. Tëtje

ceku se lidhur me këtë çështje është mbajtur një takim me subjektet politike kuvendare, me përjashtim të LDK-së, e cila nuk ka shprehur gatishmëri për të marrë pjesë, me arsyetimin se kontributin e tyre do ta jepin në këtë seancë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - kërkoi që për seancën e muajit shkurt të futet në plan të punës, një informatë për gjendjen e sigurisë në komunën tonë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të VV-së tha se për këtë çështje duhet të formohet një grup punues, i cili do të merrej me hartimin e këtij plani. Ai këtë e arsyetoi me vet faktin se takimi i thirrur nga kryesuesi i kuvendit për hartimin e këtij plani kishte më tepër karakter formal sesa këshillues dhe bashkëpunues. Ky fakt vërtetohet me atë se vet ftesa e këtij takimi ishte formale dhe në të cilën nuk ishte i bashkëngjitur agjenda apo rendi i ditës, rrjedhimisht nga kjo neve na është pamundësuar prezantimi i opinioneve, ideve dhe propozimeve tona. Në vazhdim ai ceku se fakti, se në këtë plan mungojnë data të rëndësishme, siç është "Dita e Dëshmorëve të Vushtrrisë", mandej "Dita e çlirimit", si dhe datat për seancat solemne tregojnë më së miri se ky plan ka nevojë të rishikohet dhe të rihartohet me kujdes. Pastaj ai vazhdoi duke vlerësuar se ky draft-plan është i kopjuar nga plani i vitit të kaluar në masën prej 90%. Në fund ai propozoi që draft-plani i kuvendit për vitin 2014 duhet të hartohet nga një grup punues, i cili do të formohet e ku në përbërje të tij duhet të jetë nga një anëtar nga secili subjekt politik i përfaqësuar në kuvend, mandej kryesuesi i kuvendit dhe zyrtari ligjor i komunës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se lidhur me draft-planin e punës së kuvendit për vitin 2014 është mbajtur një takim ku kanë marrë pjesë subjektet politike, tutje konsideroi se ky draft-plan është i mbarështuar mirë dhe hartuar me kujdes profesional, si i tillë, ne si grup kuvendar e përkrahim dhe të njëjtin edhe me propozimet tjera të, cilat do të inkorporohen të aprovohet në kuvend. Në fund ai njoftoi kuvendin se për shef të grupit kuvendar kanë vendosur Safet Idrizin.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - kërkoi që nga muaji mars në Draft-planin e punës së kuvendit, të futet si pikë ndryshimi i rregulloreve në fushën e arsimit, përkatësisht ndryshim –plotësimi i rregulloreve të shkollave, përfaktin se nga koha kur janë aprovuar këto rregullore, kemi edhe ndryshimin e Ligjit për arsim, andaj një ndryshim i tillë është shumë i nevojshëm.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se në bazë të akteve pozitive, janë të përcaktuara përgjegjësitet e kuvendit dhe atë si me Ligjin për vetëqeverisje lokale, ashtu edhe me Statutin e komunës, andaj në këtë drejtim shtoi se konform kompetencave të drejtive komunale, të trajtohen çështjet nga kompetencat e tyre sipas lëmive përkatëse të tyre. Pastaj ai ceku se në plan duhet të futen, të trajtohen dhe pasqyrohen detyrat dhe përgjegjësitet, të cilat komunat janë të obliguara t'i marrin e që në këtë plan nuk figurojnë. Mandaj ai ceku se është me interes që në këtë plan të futet një pikë që ka të bëjë me gjendjen fizike të objekteve shkollore. Tutje ceku se duhet të futet një informatë, e cila ka të bëjë me informimin e kuvendit, përfkriteret e lirimit nga pagesat e qirasë, të familjeve me gjendje të rëndë sociale, atyre të invalidëve dhe veteranëve të luftës, përfaktin se ky raportim është obligim statutar. Gjithashtu ai kërkoi që pjesë e planit të jetë edhe një informatë (raport) lidhur me çështjen e emërimit të rrugëve dhe shesheve të qytetit dhe të komunës në përgjithësi, gjë e cila do të ndihmonte në adresimin e këtij problemi, përfaktim nga kuvendi, pasi që dihet se pas vendimit të kuvendit, përfakti emërimi nuk kemi akoma zbatim konkret në terren të këtij projekti (emërimin e rrugëve, shesheve, vendosjen e shenjave, numrave etj). Në kontekst të hartimit të këtij plani, si kuvend kemi mjaft nevojë që të trajtohet bashkëpunimi i komunës, përkatësisht kuvendit me Agjencinë e Privatizimit, që të bëhet e ditur publikisht se çka po ndodh me pronat e komunës sonë, kemi nevojë si komunë, por edhe si qytetarë të dimë, e jo që t'i lihet në dorë kjo çështje një administratori të kësaj agjencie, përfakti çështje të rëndësishme e komplekse, siç është bartja e pronës dhe forma të tjera. Përfaktë të fundit është shumë e nevojshme të futet në plan një informatë me shkrim.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 32 vota për, 3 abstenim vendosi me sa vijon:

Aaprovohet Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2014, duke inkorporuar edhe propozimet e anëtarëve të kuvendit.

3. Shqyrtimi i propozimit për miratimin e vendimit për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se qysh në mandatin e kaluar kemi pasur kërkesa për ndryshimin e Statutit të komunës, andaj në këtë rast ai propozoi që të merret vendim për një ndryshim të tillë, dhe së bashku të shikojmë se ku kemi nevojë të bëjmë ndryshimet e duhura, qoftë në statut apo edhe në organo-gramin e komunës.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - propozoi Muharrem Shabanin për anëtar të Komisionit për ndryshimin e Statutit të komunës

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- në emër të grupit të LDK-së propozoi Shkelzen Fekën për anëtar të komisionit.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- në emër të grupit të PDK-së propozoi Xhevahire Asllanin për anëtarë të komisionit për ndryshimin e Statutit të komunës.

Bazuar në dispozitat ligjore pozitive, kryesuesi i kuvendit, dhe udhëheqësi i Zyrës Ligjore, duhet të jenë pjesë e këtij komisioni, sipas detyrës zyrtare.

Pas debateve dhe propozimeve të dhëna, Kuvendi, me vota unanim vendosi që të themelohet Komisioni për ndryshimin e Statutit, me këtë përbërje:

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit;

Xhevahire Selmani (PDK);

Shkelzen Feka (LDK);

Muharrem Shabani (AAK);

Idriz Muzaqi (Zyra ligjore).

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të komunës, komitetet e përhershme, siç janë: Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete, formohet në bazë të çelësit të caktuar të përfaqësimit të subjekteve politike në kuvend. Me këtë konsideron se një gjë e tillë në rastin konkret të këtij çelësi që është dhënë, nuk është në përputhje me këtë, por dihet edhe një element se në bazë të kushtetutës, çdo votë është e barabartë dhe se nuk mund t'i mohohet asnjë subjekti politik fuqia e votës, sepse këtë e garanton edhe Kushtetuta. Tështoj se në bazë të propozimit që është sjellë në kuvend, kemi shkelje të numrit dhe fuqisë së votës të subjektit të AAK-së në kuvend., andaj kur merret për bazë numri i votave të AAK-së del përfundimi se kjo nuk është në përputhje me numrin e anëtarëve të propozuar për KPF. Konform të cekurave më lart ai njoftoi kuvendin se grapi i AAK-së nuk do të deklarohet, në të njëjtën kohë nuk do të paraqesë kandidatë për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, pa e marrë mendimin e Departamentit Ligjor të Ministrisë të Pushtetit Lokal. Përfundimisht, në fund ai ceku se varësisht prej rrjedhës së diskutimeve dhe mendimit të marrë nga Departamenti ligjor, ne si grup më vonë do të paraqesim kandidatët tonë për KPF-në.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - tha se ky çelës i Komitetit për Politikë dhe Financa, është propozuar pikërisht në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të fundit lokale

dhe në bazë të këtyre përqindjeve AAK-së i takon një anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Me 29 vota “për”, 6 “abstenum” aprovohet çelësi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi këta emra për anëtarë të KPF-së: Mejreme Ismajli, Selim Rrustemi dhe Ilmi Azemi.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar PD-AKR-së, propozoi për anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa, Tasim Gubetinin.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të LDK-së, propozoi Ismet Gashin dhe Shkelzen Feken për anëtarë të KPF-së.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - njoftoi anëtarët e kuvendit, se në përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, duhet të respektohet barazia gjinore, gjë e cila është edhe obligim ligjor. Tështu ai duke iu referuar Ligjit për barazi gjinore, tha se duhet të respektohet kuota gjinore mes meshkujve dhe femrave, andaj kjo mbeten në vullnetin e subjekteve politike.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se në konsultim me grupin kuvendar të PDK-së kemi bërë një ndryshim në propozimet tona për anëtarë të KPF-së, andaj grupi propozon: Safet Idrizin, Mejreme Ismajlin dhe Ilmi Azemin.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit – në emër të grupit kuvendar të VV-së, për anëtarë të KPF-së propozoi Mehmet Selacin.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për”, 6 “abstenum” vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) i KK-së në Vushtrri, me këtë përbërje:

1. **Shpëtim Zhegrova, kryesuesi i kuvendit dhe i KPF-së;**
2. **Ilmi Azemi, anëtar (PDK);**
3. **Mejreme Ismajli, anëtare (PDK);**
4. **Safet Idrizi, anëtar (PDK);**
5. **Tasim Gubetini, anëtar (PD-AKR);**
6. **Ismet Gashi, anëtar (LDK);**
7. **Shkelzen Feka, anëtar (LDK);**
8. _____, anëtar (AAK);
9. **Mehmet Selaci, anëtar (LVV).**

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete.

Kuvendi në fillim të diskutimit të kësaj pike të rendit të ditës aprovoi me 26 vota “për”, tjerat “abstenum” çelësin e përbërjes së Komitetit për Komunitete.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit – tha se grupi kuvendar i VV-së vlerëson se Komiteti për Komunitete, është duke u keqkuptuar dhe të njëjtë është duke iu dhënë konotacion etnik. Tështu shtoi se ky komitet ngërthen në vete komunitetet pakicë, por jo vetëm, prandaj kjo qasje është diskriminuese dhe e mendësisë së kohës së UNMIKUT. Pastaj ceku se ne si kuvend duhet të jemi të vëmendshëm, dhe propozoi që në të, të përfshihen komuniteti i biznesit, pensionistët, lagjet e qytetit etj. Çështja tjetër e cila lidhet me këtë keqkuptim, ka të bëjë me përbërjen e këtij komiteti, ku LVV-ja është mbetur jashtë përbërjes së këtij komiteti, për të cilin nuk ka arsy. Ne kërkojmë që si subjekt të përfshihemi në përbërjen e këtij komiteti, e që ne besojmë se këtij komiteti me kalimin e kohës do t’ia japim funksionin dhe misionin e duhur që duhet ta ketë, e që

konsiston në adresimin e problemeve, kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, pa dallim etnie, duke i trajtuar të gjithë në mënyrë të barbarët.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - njoftoi se funksioni i Komitetit për Komunitete, është i rregulluar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe shumicën në këtë komitet e përbëjnë komunitetet pakicë, dhe më tutje shfaqi propozimet e komuniteteve të bëra për këtë komitet, e në të cilin bëjnë pjesë me sa vijon: Zoran Rakiç dhe Bratislav Kostić nga komunitetit serb, Enver Dubovci nga komunitetit turk, Adem Hoti nga komuniteti ashkali dhe nga komuniteti rom Aziz Emini. Nga komuniteti serb kemi dy propozime, Bratislav Kostić dhe Sreko Dimiq, kështu që duhet vendosur për njërin prej tyre.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - propozoi Fatime Hazirin për anëtarë të Komitetit Për Komunitete dhe në emër të grupit kuvendar kërkoi për secilin anëtarë të propozuar nga një arsyetim të shkurtër, përfaktin që ky kuvend para se të votojë të ketë dijen se për kë po voton.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - njoftoi se grupi kuvendar i AAK-së do ta paraqesë kandidatin e vetë për anëtar të Komitetit për Komunitete, pas konsultimeve dhe pas marrjes së mendimit ligjor nga Ministria e Pushtetit Lokal.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi për anëtar të Komitetit për Komunitete Habib Mustafën dhe Habibe Gérxhaliu.

Zoran Rakiç, anëtar i komitetit - njoftoi kuvendin me propozimet e bëra nga komuniteti serb, të cilët janë bërë me një proces zgjedhor, ku kemi pasur dy kandidatë, të cilët vijnë nga fshatrat Gojbulë dhe Gracë.

Nga dy propozimet e bëra për anëtarë të Komitetit për Komunitete mes Sreqko Dimiqit dhe Bratislav Kostićit, kandidati Brastislav Kostić me 32 vota për, zgjidhet anëtar i Komitetit për Komunitete.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 31 vota "për", 4 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit për Komunitete KK-së në Vushtrri, me këtë përbërje:

1. **Zoran Rakic, anëtar (komuniteti serb);**
2. **Bratislav Kostic, anëtar (komuniteti serb);**
3. **Enver Dubovci, anëtar (komuniteti turk);**
4. **Adem Hoti, anëtar (komuniteti ashkali);**
5. **Aziz Emini, anëtar (komuniteti rom);**
6. **Habib Mustafa, anëtar (PDK);**
7. **Habibe Gérxhaliu, anëtare (PDK);**
8. **Fatime Haziri, anëtare (LDK);**
9. _____, anëtar (AAK).

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - propozoi që në kuadër të këtij këshilli të futet edhe një përfaqësues i shoqatave të luftës, si dhe një përfaqësues i tifozëve "Forca" përfaktin se në komunën tonë të paktën kemi dy ndeshje sportive, e që kemi një numër të tifozëve përfaktin se afro 4000 veta, dhe një përfaqësim i tillë është mjaft i nevojshëm, por do të ishte mirë që edhe ndonjë OJQ-rinore, të jetë pjesë e përbajtjes e këtij këshilli.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 32 vota "për", 3 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë përbërje:

- *Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës – Kryesues;*
- *Besart Shaqiri, Komandant i Stacionit Policor – anëtar;*
- *Shemsi Rrahimi, Bashkësia Islame në Vushtrri - anëtar;*
- *Simo Cimburovic, përfaqësues i Kishës Ortodokse Serbe – anëtar;*
- *Tomislav Angjelovic, përfaqësues i komunitetit serb – anëtar;*
- *Tahir Maxhuni, përfaqësues i komunitetit turk – anëtar;*
- *Shyqyri Quni, përfaqësues i komunitetit ashkali – anëtar;*
- *Selatin Emini, përfaqësues i komunitetit rom – anëtar;*
- _____, Kryesues i Komitetit për Komunitete - anëtar;
- *Remzije Zekolli, Zyrtare për Barazi Gjinore – anëtare;*
- *Musaj Tërbunja, Drejtor i Drejtorisë për Arsim – anëtar;*
- *Bajram Beqiri, Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit – anëtar;*
- *Bajram Kela, FSK – anëtar;*
- *Ismet Saraçi, anëtar i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi për fshatrat Bivolak Zhilivodë, Gllavatin, Prelluzhë, Stroc, Bequk dhe Mihaliq – anëtar;*
- *Fatmir Feka, kryesues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi për fshatrat: Bajskë, Gojbulë, Sllatinë, Tërlabuq, Karaqë, Begaj, si dhe BL "Kalaja" Vushtrri, anëtar;*
- *Behram Rahmani, Përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale – anëtar;*
- *Tafil Hyseni, Kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;*
- *Ekrem Merovci, Përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-anëtar;*
- *Qëndrim Uka, Përfaqësues nga OJQ – anëtare;*
- *Avni Deliu, Përfaqësues i mediave lokale – anëtar;*
- *Nexhjet Osmani, Përfaqësues i Komunitetit të Biznesit – anëtar;*
- *Isak Hyseni, Përfaqësues i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara – anëtar.*

7. Të ndryshme.

- a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuar a (të lira) nga të hyrat vetanake, nga viti 2013 në vitin 2014.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime hyrëse, duke shtuar se Drejtoria për Buxhet dhe Financa, duke u bazuar në Ligjin për Buxhet të Kosovës, për vitin 2014, ku flitet për ndarjen, rindarjen e bartjes dhe obligimet e pakryera financiare nga vitet paraprake, si dhe Rregullores financiare nr.02/2013 të DBF-së, ku flitet për obligimet e papaguara, të gjitha faturat, të cilat i pranon organizata buxhetore, duhet të paguhen brenda 30 ditëve. Tutje shtoi se me qëllim të harmonizimit, koordinimit të punëve dhe procedurave ligjore dhe konform këtyre, pas barazimit të të hyrave vetanake në Departamentin e thesarit, kemi qenë të obliguar që ta dërgojmë kërkesën për bartjen e këtyre mjeteve vetanake nga viti 2013 në vitin 2014.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 32 vota "për", 3 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim barten mjetet e lira të mbeturat nga viti 2013 në vitin 2014 në shumën 417,372.95€. Shpërndarja bëhet në kategoritë ekonomike.

Shuma e mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve (kodi 111), në shumën prej 865.24€;

Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë – mallra dhe shërbime(kodi 130), në shumën 47,849.06€;

Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë – subvencione dhe transfere(kodi 200), në shumën prej 3,450.55€ (prej tyre 1.450.55 € barten në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, kurse shuma prej 2.000.00 € barten në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport për OVL-në e UÇK-së);

Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë -shpenzimet kapitale(kodi 300), në shumën 365,208.10€.

Gjithsej 417,372.95€.

b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtoreve dhe zv. drejtoreve në institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit - propozoi që në kuadër të këtij komisioni, të kemi përfaqësues nga prindërit në shkolla adekuate, si dhe një mësimdhënës apo një përfaqësues nga shkolla përkatëse, i cili do të autorizohej nga institucioni përkatës.
Musa Tërbunja, drejtor i DKA-së - paraqiti sqarime hyrëse, lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 32 vota "për", 3 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim formohet komisioni për intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:

1. *Musaj Tërbunja, Drejtor i Drejtorisë për Arsim;*
2. *Izet Miftari, Zyrtar i Drejtorisë për Arsim;*
3. _____, *Përfaqësues i Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji.*

c). Shqyrtimi i kërkesës i Kishës Ortodokse në Vushtrri, për ofrimin e ndihmës financiare.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se kërkesa e Kishës Ortodokse në Vushtrri, konsiston në mbulimin e shpenzimeve përrrymë dhe ujë, që janë shpenzuar më herët. Tëtje duke iu referuar një bisede me përfaqësuesin e kësaj kishe, ka kuptuar se kjo kishë nuk ka mundësi që të mbulojë këto shpenzime, këto janë shpenzime të vjetra dhe nuk kërkon që këto shpenzime të mbulohen në mënyrë të vazhdueshme. Në fund ai tha se këto shpenzime do të hyjnë në kuadër të "marrëveshjes përrënimin e murit në oborrin e kishës", i cili po parqet mjaft probleme, dhe i cili është një spirale që del në trotuare dhe shkakton problem në lëvizje.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 32 vota "për", 3 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndahet shuma prej 840.00 € (tetëqind e dyzet euro) nga buxheti i komunës – fondi për subvencione dhe transfere për mbulimin e shpenzimeve të

grumbulluara për pagesën e energjisë elektrike dhe të ujit të Kishës Ortodokse Serbe "Shën Ilia" në Vushtrri.

Mjetet e ndara në shumën e lartëcekur do të paguhen vetëm pas sjelljes (dorëzimit) të dëshmisë për shpenzimet e përmendura në nenin 1 të këtij vendimi.

Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Mehmet Selaci anëtar i kuvendit – kërkoi nga Zyra ligjore e komunës interpretim ligjor të neni 13.5, të Rregullores për ndarjen e dekoratave, ku thuhet se çmimi "Sportisti i vittit", shoqërohet me një shumë të mjeteve financiare të ndara nga kryetari i komunës, vlera e të cilave nuk kalon shumën prej 500 €.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - kërkoi nga Zyra ligjore që të jap opinion ligjor lidhur me statusin juridik të punëtorëve teknik (pastruesve), konkretisht të konstatohet ligjërisht se këta punëtorë a janë shërbyses civil apo jo.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

Procesmbajtësi

Bajram Bashi

Bastri Duraku

Lekturoi

Vlora Krasniqi

